REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 853-855/20
Datë/Datum. 16.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika Kosova
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.853/20
855/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi – Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "DWH Kosova"- SH.P.K- Prishtinë dhe "DWH Albania" SH.P.K- Shqipëri, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pajisje të Gjeodezisë- Kontrollera", me nr. të prok: 318-20-3654-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale", më datën: 13.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHEN**, si të pa bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "DWH Kosova"- SH.P.K- Prishtinë dhe "DWH Albania" SH.P.K- Shqipëri, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pajisje të Gjeodezisë- Kontrollera", me nr. të prok: 318-20-3654-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale".

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Pajisje të Gjeodezisë-Kontrollera", me nr. të prok: 318-20-3654-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale",

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me

Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: ""DWH Kosova"- SH.P.K- Prishtinë dhe "DWH Albania" SH.P.K- Shqipëri, i refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues "DWH Kosova"- SH.P.K- Prishtinë dhe "DWH Albania" SH.P.K- Shqipëri, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 23.10.2020 me nr. 853/20 ,dhe me 23.10.2020 me nr. 855/20 , kundër njoftimit për kontratë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pajisje të Gjeodezisë- Kontrollera", me nr. të prok: 318-20-3654-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 pika 1.1.2.3, nenin 7 pika 1.2.3.4.6, nenin 9 pika 1, nenin 24 pika 2.3, nenin 28 pika 1.2.3.4.5.6.7.8.9, si dhe nenin 32 pika 3.5 të LPP-së, te ankesa me nr. 853/20.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 pika 1.2.3, neni 7 pika 1.3.4.6 , 9.1, si dhe nenin 28 pika 1-9 e LPP-së, te ankesa me nr. 855/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 27.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 02.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Ekspert shqyrtues / teknik sqaron se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale-KPMM, me datën: 19.10.2020 ka korrigjuar dosjen e tenderit përmes formularit standard për korrigjim të gabimeve sipas vendimit te OSHP- se te datës: 14.10.2020 Nr. prot 677/20 për aktivitetin e prokurimit "Pajisje te Gjeodezisë - Kontrollera " me numër të prokurimit: 318-20-3654-1-2-1,

përmes procedurës se hapur ne harmoni me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës Nr. 04/L-042, I ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237. Ligji Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues me marrjen e vendimit te OSHP-se te datës: 14.10.2020 dhe ekspertizën e ekspertit shqyrtues ne bashkëpunim me njësinë ka bërë ndryshimet e nevojshme ne specifikimet teknike duke ngritur ne E-prokurim "Dosje te tenderit-korrigjuar", mirëpo ne fund ka ardhur ne përfundim se këto janë nevojat e AK-KPMM për ketë blerje dhe si rrjedhojë këto specifika janë bërë pjesë e dosjes se tenderit. Autoriteti Kontraktues ka veprua ne harmoni me Vendimin e OSHP-se 677/20 te dt 14.10.2020 siç është cekur edhe ne arsyetim te vendimit: Bazuar ne vendimin e OSHP-së datës 14.10.2020 nr 677/20 saktësisht ne faqe 6 të raportit paneli shqyrtues ka sugjeruar AK-KPMM qe te blihen kontroller te ri pra sipas vendimit te panelit shqyrtues leverdia

> përbërëse siç shihet në foton e bashkangjitur në raportin e ekspertit shqyrtues/teknik. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se gjatë hulumtimit të bërë për pajisjen në fjalë, i sugjeron Ak-në se me shumë do të ishte e leverdishme të bëjë furnizimin me kontroller të ri se sa të bëjë servisimin e kontrollerëve të vjetër (ekzistues) pasi ky kontroller është model i viti 2010. Pra, leverdia është të furnizohet me kontroller të ri duke parë avancimin e teknologjisë së kësaj lëmie, ku shkalla e gabimeve në matje është me e vogël në krahasim me kontrolloret ekzistues. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik obligon AK-në që të përpilojë specifikime teknike sipas nevojave të tyre dhe të definoj saktësisht se për çfarë produkte bëhet fjale, në mënyre që të kenë qasje të barabartë të gjithë OE të interesuar dhe tenderuesit që të ofrojnë zgjidhjen e tyre.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues është e pa bazuar, të mbetet në fuqi vendim i autoriteti kontraktues njoftimi për Kontratë.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 02.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 02.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues-teknik.

Operatori Ekonomik "DWH Kosova" SH.P.K.-Prishtinë, me datë 03.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues-teknikREFUZIMI Raportit 853-855/20, date 02.11.2020. E nderuar OSHP, ne jemi njohur me raportin (nëse mund te quhet raport) 853-855/20, datë 02.11.2020 te "ekspertit" shqyrtues ("E"SH).

Hapim parathesë, Kërkesa për rishqyrtim e OE është: E DREJTE LIGJORE E OE. Përgjigja ndaj kërkesës për rishqyrtim te OE është : DETYRIM LIGJOR I AK Afati tre-ditor i AK-së për përgjigje ndaj OE është: DETYRIM LIGJOR PER AK Heqja e licencës se prokurimit punonjësit publik, ne rast se nuk përgjigjet brenda afatit ligjor, është: MASE LIGJORE E DETYRUESHME DHE E PAREVOKUESHME. ....mbyllim paranthesën.

Objekti i ankimimit tone është: "MOSPERGJIGJA e AK" ndaj Kërkesës se OE për "Rishikim te Kërkesës se AK" (jo vetëm brenda afatit ligjor, por edhe sot e kësaj dite AK është ne kushtet e mos përgjigjes, ne shkelje vullnet plotë me ligjin. Pra AK nuk ka respektuar procedurën, qe i përcakton ligji dhe për këtë mban përgjegjësi ligjore si enti publik, por edhe përgjegjësi personale individuale personi i prokurimit i ngarkuar për te ndjekur këtë tender.

Heqja e licencës se prokurimit është automatike, dhe ligja nuk ja mundëson as edhe një gjykate rishikimin e heqjes se licencës. E nderuar OSHP, Për te evidentuar shkeljen e procedurës, duke mos ju përgjigjur kërkesës për rishqyrtim te OE, nuk nevojitet as Ekspert Shqyrtues, dhe aq me pak pseudo ekspert, z. Fejza, por mjafton te kontrollohen dokumentet e ngarkuar ne platformën elektronike për këtë tender, dhe datat e ngarkimit. Por z. Fejza e ka anashkaluar fare objektin e ankimimit tone, çka përben një "skandal juridik", edhe pse ai rezulton i paditur edhe ne fushën juridike, veç asaj gjeodezike, nuk e justifikon asgjë mosdijen e tij, kur ai vepron nen titullin e Ekspertit Shqyrtues. Për sa me sipër ne e refuzojmë këtë raport, si ne kundërshtim frontal dhe flagrant me ligjin e prokurimeve publike. Ne ngremë dyshimin e bazuar, qe z. Fejza nuk përmbush kërkesat minimale për ESH si ne fushën e gjeodezisë, por edhe ne fushën juridike pasi i mungon edukimi i duhur profesional, por edhe përgatitja nevojshme juridike, aq sa nuk arrin te lexoje objektin e ankimimit (padisë). Objekti i ankimimit tonë është mos përgjigja e AK ndaj kërkesës për rishikim, pra shkelja e procedurës që në një tender është e shenjte. Ne e kuptojmë fare mirë, se cilat janë motivet, qe AK lëviz konstant ne një linje jashtë ligjore, por nuk kuptojmë guximin, mos tuten dhe kundërvënien e hapur ndaj organeve gjyqësore, si edhe është OSHP duke e ditur fare mire qe vendimet 488/20 dhe 677/20 janë ne fuqi dhe përcaktojnë edhe vendimet e ardhshme te OSHP për kete tender, për sa kohe produkti mbetet po ai GRSl SCH25A. Nuk ka vendim pasardhës qe te mund ti kundervihet vendimeve 488/20 dhe 677/20. Vetëm një gjykate me e larte mund ti hidhte poshtë ato por tani qe janë ne fuqi as edhe një gjykate me e larte nuk mund ti rrezoje me ato. Ne presim nga OSHP qe te ktheje AK ne shtratin ligjor dhe te penalizojë konform ligjit personat përgjegjës te shkeljes se procedurës.

Përshëndetje institucionale.

Operatori Ekonomik "DWH Albania" SH.P.K.-Shqipëri ,me datë 03.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues-teknik.
Subjekt:853-855/20, date 02.11.2020 Eks. Raport, Titulli i tenderit:Pajisje te Gjeodezise – Kontrollera, Nr. Prokurimit:318-20-3654-1-2-1. E nderuar OSHP, ne konfirmojmë marrjen e raportit te Ekspertit Shqyrtues 853-855/20 dhe e konsiderojmë këtë raport si grumbull fjalësh pa lidhje me lenden, ligjin dhe kornizën ligjore. Është e paimagjinueshme, qe (1) dy OE te ndryshëm, (2) nga dy vende te ndryshme (njeri i te drejtës kosovare dhe tjetri i te drejtës shqiptare), (3) me numër fiskal te ndryshëm, (4) ne konkurrence me njeri-tjetrin, (5) te ankimuar veç e veç, (6) me objekt animimi te ndryshëm, (7) me argument te ndryshëm, (8) me pagese te veçante, te futen ne një praktike te vetme dhe te refuzohen me te njëjtin motiv?!
Ky është një dokument PER EXCELLENCE se si nuk funksionojnë disa instanca (ESH) te parapara me ligj ne Kosove! Çdo student i drejtësisë, pasi ka asistuar ne leksionin e pare te kodit civil, te vitit te pare ne fakultetin juridik, mëson qe: pala paditëse është një e vetme.
Ekziston edhe e ashtuquajtura padi kolektive, e cila ne ndryshim nga USA, nuk është e përfshire ne te drejtën evropiane, ne te çilen bazohet e drejta kosovare. Por edhe padia kolektive kërkon qe palët paditëse te shprehin vullnetin paraprak qe padite e tyre te bëhen bashke (kolektohen ne një padi). Por nuk mundet kurrsesi qe një organ tjetër, qofte kjo edhe gjykate, te lidh ne një padi te vetme dy padi te ndryshme, nga dy paditës te ndryshëm me interesa te ndryshme apo te kundërta, ne kundërshtim me vullnetin e paditësve edhe kur i padituri është i njëjte. Pra lidhja e lendes 833/20 me lenden 855/20 është shkelje e hapur ligjore. Por për z. Fejza këto janë te panjohura, edhe pse ai mban titullin e Ekspertit Shqyrtues. Me pa te drejte, natyrisht.
Z. Lavdim Fejza - bazuar ne raportin miserabel qe ka ofruar si përmbajtje, forme dhe rekomandim - vërteton vetëm një gjë: QE TITULLIN E EKSPERTIT SHQYRTUES E KA MARRE DHE E MBAN NE MENYRE MANIPULATIVE. Te jesh Ekspert ligjor kërkohet:
te kesh edukim profesional universitar te plote ne fushën ku vepron (ne këtë rast ne gjeodezi), qe z. Fejza nuk e ka te kesh eksperience shumë vjeçare ne këtë fushe (gjeodezi), qe z. Fejza nuk e ka, pasi nuk përmbush piken a) te kesh dinjitet dhe integritet profesional dhe njerëzor, qe z. Fejza nuk e ka, se nuk përmbush as piken a) dhe as piken b). Pra z. Fejza si ESH gjen shprehje ne vargjet e Fan S. Noli: "Ti Halim qe s'di këndim, je vezir për arsim" Kjo ndodh ne Kosove ne vitin 2020! 0 Tempora, 0 Mores!
E nderuar OSHP, problematika është fare e thjeshte. AK kërkon te blejë ne mënyrë te kamufluar GPS te ri, por sipas AK "Kontrollera te rinj". Pra, sipas AK, produkt i pjesshëm. AK shpjegon, qe kontrollerat kontrollerat ekzistues nuk janë me defekt (si kështu?) janë riparuar dhe servisuar disa here (pra kane thithur fonde publike ne vazhdim) por nuk kane ndriçim (pra janë kualitet i dobët qe

nga fabrika). Riparimi i ndriçimit kushton 14 deri 15 here me lire se buxheti i paraqitur, (!!!). Lind pyetja qfare e shtyn AK te shpenzoje një shume 14 -15 here me te larte se shuma e riparimit?Përgjigja është ne aritmetiken e shifrave:X=A-3BA - Vlera e tenderit (buxheti)B - Vlera e Kontrollerit individëve te veçante ne AK, i intereson X, i cili me pas i nënshtrohet një procesi paralel rishpërndarje ku aktoret ndryshojnë rolet (marrësi behet dhënës dhe dhënësi behet marres). Sa me i madh X, aq me i madh interesi, sa me i madh interesi, aq me e forte këmbëngulja. Por qe te mundësohet X, kërkohet shmangia e OE konkurrente, e cila kërkon shmangien e hapjes se tenderit, e cila kërkon shmangien e produkteve te tjera, te plota, e cila kërkon shmangien e kërkesës ligjore, e cila kërkon shmangien e OSHP, e cila kërkon manipulimin e ESH, i cili bazohet ne pa aftësinë profesionale (mos ta këtë idenë për ca flitet) dhe ne mungesën e integritetit, i cili shkon paralel me paaftësinë. Por këtu jemi edhe para një non-sensi juridik, dhe ky është problemi me serioz. AK për te treten here (shiko tabelën ne vazhdim) kërkon te blejë një produkt te caktuar (GRSl SCH25A) dhe dy here me vendim OSHP është rrezuar. Çfarë e shtyn z. Fejza, pavarësisht nga paaftësia profesionale, te rekomandoje aprovimin e vendimit te AK, kur kërkesa dhe produkti vazhdon te jete i njëjti? Nga burojnë pritshmërie e tij dhe te AK, qe OSHP këtë here - duke prapuar vetveten - do te mund te aprovonte vendimin e AK, i cili është po ai (GRSl SCH25A), qe është rrezuar dy here me radhe nga OSHP? Çfarë i konsideron z. Fejza vendimet 488/20 dhe 677/20 te OSHP, vendime juridike apo hajgere juridike? A e di z Fejza, qe vendimet 488/20 dhe 677/20 nuk janë ankimuar nga palët dhe kane fituar fuqi ligjore dhe fuqia ligjore është nga data e hyrjes ne fuqi dhe me pas, dhe si te tilla nuk lejojnë një vendim te kundërt me to për asnjë organ, duke përfshirë edhe OSHP, për sa kohe kërkesa dhe produkti janë te njëjtë.

Me qarte qe ta kuptoje edhe z. Fejza. Vendimet 488/20 dhe 677/20 kushtëzojnë edhe vendimet ne vazhdim kur kërkesa dhe produkti janë te pandryshuar (pra GRSl SCH25A), pra vendime 488/20 dhe 677/20 kushtëzojnë 100% vendimin 853/20 dhevendimin 855/20.

Data	Kërkesa tenderit	Vendimi OSHP	Rezultati i vendimit te
14.07.202	GRS1SCH25A		
09.09.202		488/20	Rrezon vendimin e AK
14.09.202	GRS1SCH25A		
14.10.202		677/20	Rrezon vendimin e AK
19.10.202	GRS1SCH25A		
xx.xx.202		853/20	i hapur

KONKLUZION:

Ne e refuzojmë raportin e jo-ekspertit, por shqyrtuesit, z. Fejza, por shprehim njëkohësisht alergjinë profesionale, morale, etike dhe estetike, qe na krijon ky dokument manipulativ i paraqitur prej tij. I kërkojmë OSHP qe ne kushtet qe kërkesa është e njëjtë (GRSl SCH25A) te ruaje dhe survejoje mos

cenimin e vendimeve 488/20 dhe 677/20. Po kështu i kërkojmë OSHP, te verifikoje autencitetin e titullit te z. Fejza si Ekspert Shqyrtues, ne fushën e gjeodezisë, i cili nuk ka kapacitetet minimale, dhe për këtë titull nevojiten kapacitete maksimale (edukim adekuat universitar). Përshëndetje miqësore.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.
Lidhur me pretendimin e OE ankues DWH Kosova"- SH.P.K- Prishtinë dhe "DWH Albania" SH.P.K- Shqipëri, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues / teknik pasi qe eksperti eshte i lemise teknike dhe Ing. i fushës, sqaron se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale-KPMM, me datën: 19.10.2020 ka korrigjuar dosjen e tenderit përmes formularit standard për korrigjim të gabimeve sipas vendimit të OSHP-së të datës 14.10.2020 Nr. prot. 677/20 për aktivitetin e prokurimit "Pajisje te Gjeodezisë - Kontrollera " me numër të prokurimit: 318-20-3654-1-2-1, përmes procedurës së hapur në harmoni me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237. Ligji Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Po ashtu, autoriteti kontraktues me marrjen e vendimit të OSHP-së të datës 14.10.2020 dhe ekspertizën e ekspertit shqyrtues në bashkëpunim me njësinë ka bërë ndryshimet e nevojshme në specifikimet teknike duke ngritur në e-prokurim "Dosje te tenderit-korrigjuar", mirëpo në fund ka ardhë në përfundim se këto janë nevojat e AK-KPMM për ketë blerje dhe si rrjedhojë këto specifika janë bërë pjesë e dosjes se tenderit. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me Vendimin e OSHP-së PSH.nr.677/20 të dt. 14.10.2020 siç është cekur edhe në arsyetim të vendimit: Bazuar ne vendimin e OSHP-së datës 14.10.2020 nr 677/20 saktësisht ne faqe 6 të raportit paneli shqyrtues ka sugjeruar AK-KPMM që të blihen kontroller të ri. Pra, sipas vendimit të panelit shqyrtues leverdia është të blihen kontroller të ri, sikurse është cekur në vendimin paraprak të OSHP-së.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se AK ka bërë ndryshimet e nevojshme në dosje të tenderit sikurse janë dhënë sqarimet në raportin e ekspertit paraprak dhe vendimit paraprak të Panelit Shqyrtues. Pra, dosja e

tenderit me ndryshimet e bëra sipas sqarimeve të ekspertit, nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Kriteret dhe kërkesat e AK-së janë për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar të marrin pjesë në këtë tender dhe si të tilla nuk i referohen ndonjë operatori ekonomik të veçantë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale";

1x1 OE "DWH Kosova "- SH.P.K- Prishtinë;

1x1 OE "DWH Albania" SH.P.K,-Shqipëri;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.